

OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT OST

Për: BOE “Marsi & Al” sh.p.k L21502014K, me adresë: Tirane Farke FARKE Ambient zyre, Qendra Blur, Kati 1,Lunder &“KOAN” sh.p.k Nipt K41710001D, me adrese : Rruga Vaso Pasha, Pallati 27, Shkalla 3, Kati Zero , Tirane

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” - me mjete elektronike-pune, me REF-NR. UP.3250/7Prot., Dt.12.06.2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës:“Pajisje e punonjësve të OST sh.a. me veshje pune dhe mjete mbrojtese”

Kohëzgjatja e kontratës:1 (nje) Muajnga hyrja në fuqi e kontratës.

Fondi Limit:46.880.135 (dyzet e gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë)Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Numri i references i procedures:REF-74960-06-14-2018

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 12.07.2018.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Nr.25,
Datë 25.06.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 3(tre) ofertues, me vlerat përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. BOE “Marsi & Al” sh.p.k& “KOAN” sh.p.k	39,425,500 Lekë pa TVSH
2. “Malbertex” sh.p.k	44,009,200 Leke pa TVSH
3. “W – Center” sh.p.k	45,445,445 Leke pa TVSH

Jane Skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. “Malbertex” sh.p.k” sh.p.k	me vlerë	44,009,200 Leke pa TVSH
2. “W – Center” sh.p.k		45,445,445 Leke pa TVSH

Perkatesisht per Arsyet e mëposhtme:

1. “Malbertex” sh.p.k

- *Nuk ka permbushur piken 2.3.2, pasi sipas dokumentave te paraqitura nga OE, kuptohet se mallrat qe do te dorezohen jane prodhuar nga kompania DELTA PLUS HELLAS, GIROMONDO sh.p.k dhe MALBERTEX. DELTA PLUS HELLAS ka autorizuar si distributorin e saj ne Shqiperi kompanine Univers Promotion sh.p.k dhe kjo e fundit ka leshuar nje autorizim distributor per MALBERTEX sh.p.k ku e autorizon kete te fundit te furnizoj mallrat e kompanise DELTA PLUS HELLAS sipas katalogut te kesaj te fundit. Duke veshtruar me kujdes kataloget e paraqitura rezulton se ne total jane paraqitur 4 katalog:*

Delta Katalog OST

Delta Product Kominoshe

Katalog_2018

Katalogu i Perkthyer

Si fillim Delta Katalog OST, eshte nje katalog i cili nuk kuptohet i cilit prodhues eshte pasi ne katalog nuk ka asnje te dhene te prodhuesit, megjithate ne kete Katalog jane paraqitur disa nga mallrat objekt prokurimi si kominoshe, xhakete, pantallona, doreza dhe mbrojtës i frymemarrjes.

Se dyti, katalogu Delta Product Kominoshe nuk eshte i perkthyer ne gjuhen shqipe dhe paraqet vetem produktin Kominoshe.

Se treti eshte paraqitur Katalogu i Perkthyer i cili gjithshu nuk dihet se ciles kompani prodhuese i perket. Ne kete Katalog jane paraqitur disa produkte si helmata, kapele, xhaketa, kominoshe, kepuce, cizme, syze, mushama shiu, jelek fosforeshent.

Se katerti ne Katalog_2018 jane paraqitur produktet e prodhuara nga vete firma MALBERTEX.

Kompania GIROMONDO sh.p.k nuk ka asnje produkt te ofruar te pakten me katalog.

Nuk behet lidhja midis prodhuesit DELTA PLUS HELLAS dhe kataloget e paraqitura.

Ne perfundim KVO e ka te pamundur te lidhi Autorizimet me mallrat e ofruar me perjashtim te mallrave te ofruar nga vete prodhuesi MALBERTEX.

- Nuk ka plotesuar piken 2.3.3, pasi per mallrat e pretenduara te ofruara nga prodhuesit DELTA PLUS HELLAS dhe GIROMONDO sh.p.k nuk ka paraqitur ISO 9001 te ketyre prodhuesve
- Nuk ka plotesuar piken 2.3.4, pasi per mallrat e pretenduara te ofruara nga prodhuesit DELTA PLUS HELLAS dhe GIROMONDO sh.p.k nuk ka paraqitur ISO 14001 te ketyre prodhuesve.
- Nuk ka plotesuar piken 2.3.5, pasi kataloget (Delta Katalog OST), (Delta Product Kominoshe) dhe (Katalog i Perkthyer) nuk kuptohet se cilit prodhuesi i perkasin dhe (Delta Product Kominoshe) nuk eshte i perkthyer ne gjuhen Shqipe.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.6, pasi ditet e hapjes se ofertave sipas PV te mbajtur nuk ka paraqitur mostrat per produktet. Nuk ka paraqitur mostren per zerin 19 dhe 21 te formularit te ofertes, pasqyruar kjo ne PV e mbjatur.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.8, pasi OE ka paraqitur nje Autorizim nga kompania MERKELTEKST TEKSTIL, e cila autorizon MALBERTEX te perdor certifikaten e tyre OEKO-TEX. Autoriteti Kontraktor ka kerkuar "Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikate Standart 100 OEKO-tex te prodhuesit te vlefshme, qe duhet te aplikohet ne fushen e veprimtarise se materialeve te kerkuara" MERKELTEKST TEKSTIL qe zoteron certifikaten OEKO-tex, nuk eshte prodhuesi i mallrave te ofruara. Si perfundim OE nuk ka paraqitur certifikata OEKO-tex te prodhuesve, nga te cilet pretendon se do te marri mallrat, perfshire veten e tij si prodhues.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.9, pasi nuk gjendet asnje dokument qe provon se per Artikullin Kominoshe Zjarrduruese te ofruara nga prodhuesi DELTA PLUS te zoterohet certifikata PPE(89/686/EEC) te prodhuesit/distributorit

2. "W - Center" sh.p.k

- Nuk ka permbushur piken 1(A) te kriterave te pergjithshme pasi nuk ka ne fushen e veprimtarise se tij objektin e prokurimit.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.2, pasi OE ka paraqitur vetem nje autorizim prodhuesi nga firma BEESWIFT dhe katalogun perkates te kesaj firme, te cilen e ka perkthyer dhe noterizuar. Ne kete katalog mungojne te pakten produktet kapele pune, doreza pune, doreza te mbushura, size mbrojtese, kostum klasik per burra, kostum klasik per gra, kepuce klasike per burra, kepuce klasike per gra. Kravata, etj per rrjedhoj OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi per te gjitha mallrat objekt prokurimi.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.3, pasi per prodhuesin BEESWIFT nuk eshte paraqitur asnje certifikate ISO 9001.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.4, pasi per prodhuesin BEESWIFT nuk eshte paraqitur asnje certifikate ISO 14001
- Nuk ka permbushur piken 2.3.5, pasi ne katalogun e firmes BEESWIFT nuk jane paraqitur te gjitha mallrat objekt prokurimi.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.8, pasi certifikata e perkthyer dhe noterizuar OEKO-tex e paraqitur i perket prodhuesit SILVIA BIGAGLI TESSUTI S.R.L dhe jo prodhuesit BEESWIFT produktet e se ciles firme jane ofruar.
- Nuk ka plotesuar piken 2.3.10 pasi per muajin Dhjetor 2017 dhe per muajin Janar 2018 nuk ka numrin e nevojshem te punonjesve te siguruar.

* * *

Dukeiu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “Marsi & Al” sh.p.k L21502014K, me adresë: Tirane Farke FARKE Ambient zyre, Qendra Blur, Kati 1,Lunder & “KOAN” sh.p.k Nipt K41710001D, me adrese : Rruga Vaso Pasha, Pallati 27, Shkalla 3, Kati Zero , Tirane me një vlerë të përgjithshme prej 39,425,500 (tridhjet e nent milion e katerqind e njezet e pese mije e peseqind) Lekë pa TVSH,është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me *adresë Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 10(dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të proçedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.07.2018

Ankesa:PO, kthyer pergjigje me Vendimin Nr.5493/3 Prot, date 31.07.2018.